AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Shkurt 2024

08.03.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Shkurt 2024, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 2,2% vjetore dhe 0,1% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,2% në muajin shkurt 2024, krahasuar me muajin shkurt 2023. Inflacioni mujor ishte 0,1% në muajin shkurt 2024.

Shkurt 2024 / Shkurt 2023 2,2 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej (2,2 %) në muajin Shkurt 2024 krahasuar me muajin Shkurt 2023.

Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: energjia elektrike (11,5%), pijet alkoolike (11,2%), pemët (10,1%), peshqit (9,4%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (8,3%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (7,7%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (6,5%), biletat e fluturimeve (6,3%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (6,2%), prodhimet ushqimore (5,8%), kafja, çaji dhe kakao (4,4%), veshje (3,9%), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (3,4%), kujdesi personal (3,3%), perimet (3,0%), shërbimet hoteliere (2,8%), duhani (2,7%), buka dhe drithërat (2,3%) dhe mishi (1,3%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,6 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat (-6,0%), qumështi, djathi dhe vezët (-5,8%), pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (-2,2%) dhe blerja e automjeteve (-0,5%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4 për qind në IHÇK-it.

Shkurt 2024 / Janar 2024 0,1 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej (0,1 %) në muajin Shkurt 2024 krahasuar me muajin Janar 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOPI-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (3,8%), perimet (2,1%) dhe kafja, çaji dhe kakao (2,1%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,4 për qind në IHÇK-it.

Rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet: biletat e fluturimeve (-11,5%), energjia elektrike (-3,7%) dhe qumështi, djathi dhe vezët (-1,4%) me një ndikim prej -0,3 për qind në IHÇK-it.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2024 në ‰	II - 2024 2015=100	II- 2024 I- 2024	II - 2024 II - 2023
00	Gjithsej IHÇK	1000,0	130,4	0,1	2,2
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	351,1	145,0	0,2	1,5
02	Pijet alkoolike, duhani	67,6	139,6	0,1	5,3
03	Veshje dhe këpucë	40,6	107,0	-0,7	3,2
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,8	128,2	-0,8	7,0
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	63,0	121,7	0,7	3,6
06	Shëndetësia	22,8	116,2	0,1	2,1
07	Transporti	176,7	121,9	0,6	-0,4
08	Mjetet e komunikimit	23,7	114,5	0,0	-0,3
09	Rekracioni dhe kultura	44,5	106,4	-0,1	5,1
10	Arsimi	6,9	104,0	0,0	-0,9
11	Restorantet dhe hotelet	40,8	129,5	-0,1	2,7
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	72,2	118,8	0,0	1,8

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin shkurt 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation